



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIM I MATURËS SHTETËRORE 2025

ME ZGJEDHJE – SESIONI I

Skemë vlerësimi

Lënda: Filozofi dhe Sociologji
Varianti A

24 qershor 2025

Përgjigjet e sakta për pyetjet me alternativa

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Alternativa e saktë	A	D	B	C	D	C	A	D	D	B
Pyetja	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27
Alternativa e saktë	A	A	B	C	A	C	C	C	B	A

Vlerësimi është 1 pikë për çdo përgjigje të saktë

Pyetjet me zhvillim

Shënim: Për pyetjet me zhvillim, nxënësi fiton pikë, edhe nëse jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta.

Sociologji

Pyetja 11
Model përgjigjeje

- norma udhëzuese. Në këtë rast udhëzojnë se mund të qëndrohet në shtëpi të burrit të ndjerë ose në shtëpi të prindërve.
- norma ndaluese që njihen ndryshe edhe si “tabu” e cila tregon se nuk mund të lidhet martesë ndërmjet një burri dhe një gruaje me afri gjaku.

2 pikë nëse shpjegon dy llojet e normave kulturore;
1 pikë nëse shpjegon një nga normat kulturore;
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12
Model përgjigjeje

- Mësojnë të ndërveprojnë me njerëz të tjerë të cilët mund të jenë të ndryshëm në aspektin, racor, gjinor, nënkulturor, etj. Zhvillojnë aftësi të punës në grup.

- edukimi i vlerave të rëndësishme si barazia, toleranca, etj.
- nxënësit zhvillojnë aftësi të ndërveprimit social bazuar në qëndrime etike, duke respektuar diversitetin.
- zhvillojnë aftësi përmes programit mësimor të fshehtë që ndikon në përvetësimin e vlerave kulturore të rëndësishme si toleranca dhe për të mësuar dhe përshtatur vlerave të shoqërisë në të cilën jetojmë.
- Etj.

2 pikë nëse shpjegon dy funksione të shkollës në shoqërizim;

1 pikë nëse shpjegon një funksion të shkollës në shoqërizim;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13

Model përgjigjeje

- Sjellja deviante përcaktohet në marrëdhënie me norma kulturore të caktuara, ajo që përcaktohet deviante për një kulturë mund të mos jetë për një kulturë tjetër, bazuar në vlerat dhe normat që ajo ka.
- Rrethanat shoqërore-një sjellje ose një model veshje mund të përcaktohet si deviante ose jo bazuar në rrethanat e shoqërisë.
- Pozita shoqërore e individit ndikon në përcaktimin e sjelljes ose modelit të veshjes si deviancës ose jo, bazuar në statusin që ka në shoqëri.
- Ndryshime në rrjedhën e kohës- kuptimi për deviancën është dinamik.

4 pikë nëse shpjegon katër faktorë që ndikojnë në kuptimin relativ të deviancës;

3 pikë nëse shpjegon tre faktorë që ndikojnë në kuptimin relativ të deviancës;

2 pikë nëse shpjegon dy faktorë që ndikojnë në kuptimin relativ të deviancës;

1 pikë nëse shpjegon një faktorë që ndikon në kuptimin relativ të deviancës;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14

Model përgjigjeje

Model përgjigjeje

- Nga të dhënat statistikore, rezulton se numri i grave dhe vajzave të diplomuara është më i lartë se ai i burrave dhe djemve, megjithatë në fushën e punësimit vihet re se pagat më të larta dhe në role drejtuese janë burrat dhe djemtë.
- Referuar një modeli tradicional socializimi që lidh gratë me rolin përkujdesës për familjen dhe përkushtimin ndaj punëve të shtëpisë, vihet re se koha që ato i kushtojnë këtij angazhimi familjar është e konsiderueshme. Në këtë mënyrë zvogëlohen mundësitë për të përparuar në karrierën profesionale, politike, etj.
- Ndërsa flitet për meritokraci, sociologët kanë vënë re se ende gratë dhe vajzat përballen me vështirësi të përparimit në karrierë. Këto pengesa sociologët i quajnë si tavan i qelqtë, për të simbolizuar një sistem pengesash që pengojnë gratë dhe vajzat të zhvillohen në role drejtuese dhe të kenë paga të larta.
- Etj.

3 pikë nëse analizon tre drejtime kryesore të pabarazisë ndërgjinore;

2 pikë nëse analizon dy drejtime kryesore të pabarazisë ndërgjinore;

1 pikë nëse analizon një drejtim kryesor të pabarazisë ndërgjinore;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 15**Model përgjigjeje**

- Krijimi i marrëdhënieve jopersonale dhe racionale, motivuar nga interesi vetjak. Këto raporte nuk mbështeten mbi traditën.
- Diferencimi i roleve. Në zonat urbane njerëzit realizojnë role të dallueshme dhe inkurajohen në krijimin e identiteteve sipas premisave vetjake.
- Jetesa në qytet përfaqëson krijimin e marrëdhënieve me solidarësi të dobët, kryesisht marrëdhënie të sipërfaqshme.
- Mjedis urban nxit një ndjenjë anonimat. Në përditshmërinë e tyre njerëzit përjetojnë ndërveprime shoqërore të përkohshme që u mungon familjariteti personal. Jetesa me ritme të shpejta ndikon në një ndjenjë shkëputje dhe kultivim të qëndrimeve të zbehta.
- Qytetet janë qendra e zhvillimit ekonomik duke paraqitur më shumë mundësi për zhvillim në karrierë, zhvillim të aftësive të specializuara dhe shprehje të lirë të vetes duke inkurajuar diversitetin.

3 pikë nëse analizon tri veçori të mënyrës së jetesës në qytet;

2 pikë nëse analizon dy veçori të mënyrës së jetesës në qytet;

1 pikë nëse analizon tri veçori të mënyrës së jetesës në qytet;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16**Model përgjigjeje**

- të realizojnë ndryshime të kufizuara në shoqëri, të cilat ndikojnë në promovimi i drejtësisë sociale dhe zhvillimin e demokracisë.
- edukon një mjedis të sigurt, pranues, bashkëpunues, duke zhvilluar vlera të përbashkëta, të cilat udhëheqin praktikën e përditshme dhe proceset e ndryshme institucionale.
- inkurajon modele të menduarit, sjelljes që pohojnë përparimin, demokracinë, duke kultivuar zhvillimin e qëndrueshëm.
- promovon drejtësi dhe përfshirje më të madhe sociale. Zhvillimi i politikave arsimore që synojnë integrimin e nxënësve pavarësisht nga dallimet, synon që ta bëjë sistemin shkollor më të drejtë për të gjithë grupet e shoqërisë.
- Parimi gjithëpërfshirës ndihmon në kapërcimin e qëndrimeve diskriminuese të cilat shpesh rrjedhin nga mungesa e njohjes, ndërveprimit. Kjo reformë mbështet rrëzimin e barrierave me bazë gjinore, përkatësie etnike, aftësie etj.
- etj.

3 pikë nëse vlerëson tre qëllime të lëvizjes shoqërore reformuese;

2 pikë nëse vlerëson dy qëllime të lëvizjes shoqërore reformuese;

1 pikë nëse vlerëson një qëllim të lëvizjes shoqërore reformuese;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17**Model përgjigjeje**

- Në shoqëritë moderne shumica e njerëzve zgjedh vetë për çështjet e besimit fetar dhe stilin e jetesës.
- Mundësi të shumta në karrierën profesionale, politike e shoqërore e shumicës së njerëzve në shoqërinë moderne përcaktohet nga talentet dhe vullneti i gjithsecilit. Jeta moderne ofron shumëllojshmëri mundësish në saj të teknologjisë, globalizmit, lëvizshmërisë, duke lejuar zgjedhje në karrierën profesionale dhe ndikuar në përmirësimin e stilit të jetesës bazuar në zgjedhje vetjake.
- Shumica e njerëzve kanë mundësi të gjera ligjore dhe ekonomike, për të përzgjedhur vetë vendbanimin/ profilin

- e shkollimit/ profesionin /orientimin politik / stilin e jetesës, etj.
- Ky proces, që Peter Berger-i e quajti individualizim të mënyrës së jetesës, i jep mundësinë çdo individi të ndërtojë jetën e tij, pavarësisht nga lidhjet familjare, shoqërore apo paragjykimeve mbi prejardhjen e tyre. Çdo njeri zgjedh stilin e tij të jetesës bazuar në preferencat personale.
 - Jeta moderne ofron liri në formimin dhe përcaktimin e marrëdhënieve ndërpersonale. Normat sociale janë larg pritshmërive tradicionale duke lejuar individët të zgjedhin modelet e tyre në strukturën familjare, në format alternative të jetesës në çift, si bashkëjetesë etj.
 - etj.

- 3 pikë** nëse përshkruan tri mundësi që ofron shoqëria moderne u ofron individëve;
2 pikë nëse përshkruan dy mundësi që ofron shoqëria moderne u ofron individëve;
1 pikë nëse përshkruan një mundësi që ofron shoqëria moderne u ofron individëve;
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Filozofi

Pyetja 28

Model përgjigjeje

Sipas sofistëve (Protagorës), ekzistonte:

- **Subjektivizmi i perceptimit:** çdo individ e interpreton dhe përjeton botën sipas mënyrës së tij dhe ky perceptim është realiteti i vetëm për të.
- **Relativizmi i së vërtetës:** ata (Protagora) besonin se e vërteta është relative dhe varet nga individi. Kjo do të thotë se çdo njeri ka një perceptim të ndryshëm të realitetit dhe se nuk ka një të vërtetë absolute që është e njëjtë për të gjithë. Çdo individ është "masa" e realitetit të tij. Nuk ka një të vërtetë përfundimtare, ndaj Protagora shprehej "ka dy anë për çdo çështje".
- **Dyshimi mbi moralin:** nuk besonin në një sistem moral të përcaktuar nga natyra, por besonin se normat morale janë relative dhe të diskutueshme, ndaj ato janë të ndryshueshme. Ata besonin se nuk ka standarde të pandryshueshme për të mirën, të keqen, të drejtën e të gabuarën, sepse janë krijuar nga njerëzit dhe ndryshojnë në kohë dhe nga një kulturë në tjetrën.
- **Përparësia e arsytimit:** ata besonin se individët duhet të përdorin arsyen dhe argumentin për të arritur në përfundime rreth asaj që është e drejtë apo e gabuar. Për ta, aftësia për të bindur dhe për të argumentuar ishte më e rëndësishme se çdo normë absolute morali. Arsyetimi i ndihmon njerëzit të arrijnë zgjidhje më të mira, por jo përfundimtare, absolute.

- 4 pikë** nëse përshkruan katër tipare të filozofisë sofiste;
3 pikë nëse përshkruan tre tipare të filozofisë sofiste;
2 pikë nëse përshkruan dy tipare të filozofisë sofiste;
1 pikë nëse përshkruan një tipar të filozofisë sofiste;
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 29

Model përgjigjeje

- Çlirimi i njeriut nga frika e perëndive dhe inkurajimi i një kuptimi racional të botës natyrore.
- Çlirimi i njeriut nga frika e vdekjes, pasi për aq kohë sa ne jemi gjallë ajo nuk është.
- Rëndësia e reflektimit filozofik, vetëdijes dhe menaxhimit të frikës.
- Ekuilibrimi i dhimbjeve të trupit dhe të shpirtit.
- Përqendrimi në kënaqësitë e thjeshta të cilat shmangin dhimbjen ose ankthin.

- Vlerësimi i kohës me shoqërinë. Miqësia është një vlerë që sjell kënaqësi.
- Kultivimi i maturisë. Shmangia e dëshirave të panevojshme për të arritur ataraksinë dhe aponinë.
- Ruajtja e ekuilibrit të dhimbjeve të trupit dhe të shpirtit.

3 pikë nëse shpjegon tri nga rrugët që sipas Epikurit na ndihmojnë të jetojmë një jetë të qetë e të lumtur;
2 pikë nëse shpjegon dy nga rrugët që sipas Epikurit na ndihmojnë të jetojmë një jetë të qetë e të lumtur;
1 pikë nëse shpjegon një nga rrugët që sipas Epikurit na ndihmojnë të jetojmë një jetë të qetë e të lumtur;
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 30

Model përgjigjeje

- Ndikimi i fesë dhe kishës në të gjitha aspektet e jetës social-kulturore.
- Filozofia ndërthuret me dogmat fetare.
- Feja dominon mbi shkencën dhe pengon përparimin.
- Në qendër të krijimtarisë artistike janë shenjtoret.
- Fuqizimi ekonomik e politik i kishës mbi shtetin.
- Etj.

4 pikë nëse përshkruan katër tipare kryesore të mendimit filozofik e realitetit në Mesjetë;
3 pikë nëse përshkruan tre tipare kryesore të mendimit filozofik e realitetit në Mesjetë;
2 pikë nëse përshkruan dy tipare kryesore të mendimit filozofik e realitetit në Mesjetë;
1 pikë nëse përshkruan një tipar kryesore të mendimit filozofik e realitetit në Mesjetë;
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 31

Model përgjigjeje

- Xhon Loku, filozofi liberal që mbështeste të drejtat dhe liritë natyrore të njeriut (liria e mendimit, tolerancë në besimin fetar, barazi midis burrit dhe gruas, e drejta e pronës, etj.).
- Njerëzit “nënshkruan” kontratën shoqërore për të krijuar shtetin në mënyrë që të garantoheshin të drejtat. Me daljen nga gjendja e natyrës dhe krijimin e shtetit është populli që zgjedh përfaqësuesit e tij.
- Me “nënshkrimin” e kontratës shoqërore, ligjet do të përcaktonin standardet e gjyqimit për çështje të caktuara, ndryshe nga gjendja natyrore në të cilën vepronin gjykimet vetjake, subjektive. Respektimi i ligjeve që vepron mbi parime të standardizuara të së drejtës janë të domosdoshme për një shoqëri demokratike.
- Loku bëhet promotor i ndarjes së pushtetit (legjislativ, ekzekutiv, federativ), në mënyrë që të kishte një qeverisje të drejtë, jo të korruptuar, jo tiranike. Pushteti legjislativ do të kishte peshën kryesore meqenëse zgjidhet nga shumica e popullit.
- Xhon Loku kundërshtoi teorinë e qeverisjes së mbretërve në bazë të së drejtës hyjnore, duke argumentuar se të gjithë njerëzit lindin me të drejta natyrore si e drejta për jetën, lirinë, pronën.
- Shteti duhet të mbroj të drejtat dhe liritë e njeriut. Në rast se kjo nuk ndodh, sundimtarët mund të largohen forcërisht nga rebelimi masave.
- Përligjja e rezistencës si një masë ndaj padrejtësive politike-bërje. Në këtë mënyrë, Loku përligj rebelimin e njerëzve në kushtet kur qeveria nuk i shërben interesave të shumicës.
- Promotor i bashkëjetesës, tolerancës fetare dhe politike.
- Shteti duhet të ketë karakter laik, ndarje të shtetit nga kisha.
- Etj.

3 pikë nëse vlerëson tri parime politike të Lokut;
2 pikë nëse vlerëson dy parime politike të Lokut;
1 pikë nëse vlerëson një parim politik të Lokut;
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 32

Model përgjigjeje

- **Ankthi**

- çdo zgjedhje që bëjmë në liri na përcakton si individë dhe kjo barrë e përgjegjësisë, që njeriu i lirë duhet të mbajë, i shkakton atij, një ankth të vazhdueshëm;
- ankthi vjen kur njeriu (jaqenia ose Dasein), zbulon dramën e kotësisë së qëllimeve të tij, sepse është një qenie e vdekshme. Njeriu e kupton fundin e ekzistencës së çdo gjëje, edhe të vetvetes;
- ankthi vjen kur njeriu (jaqenia ose Dasein), zbulon se është i lirë dhe ekzistenca e tij është një rastësi. Prandaj ai duhet të kryejë zgjedhje të lira e jo të gatshme.
- thelbi i ankthit është fakti se duke qenë i lirë ai shfaq përgjegjësi për pasojat që do të krijojë zgjedhja.

- **Përgjegjësia**

- njeriu është i hedhur në këtë botë nga rastësia, pra nuk e zgjedh se ku, nga kush dhe kur do të vijë në jetë;
- kur vjen në këtë botë, atij i duhet të marrë vazhdimisht vendime për të krijuar veten dhe marrëdhëniet me të tjerët dhe kjo është përgjegjësia e tij. Askush tjetër nuk mund të vendosë në emër të tij;
- meqenëse vjen vetëm njëherë në jetë, njeriu përpiqet të bëjë gjëra që janë origjinale dhe e dallojnë nga të tjerët;
- njeriu ka plane për të ardhmen, cilësia e të cilave e bën të dallueshëm dhe i jep kuptim jetës së tij.
- Ekzistenca është proces zgjedhjesh vetjake– opinionin e nxënësit nga pikëpamja filozofike

3 pikë nëse analizon konceptin e ankthit e përgjegjësisë sipas Haidegerit dhe shpreh qëndrimin e tij për ekzistencën si proces zgjedhjesh vetjake;

2 pikë nëse analizon konceptin e ankthit ose përgjegjësisë sipas Haidegerit dhe shpreh qëndrimin e tij për ekzistencën si proces zgjedhjesh vetjake;

1 pikë nëse analizon konceptin e ankthit ose përgjegjësisë sipas Haidegerit; nëse shpreh qëndrimin e tij për ekzistencën si proces zgjedhjesh vetjake;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 33

Model përgjigjeje

- -Një edukim i suksesshëm nuk mund të jetë vetëm teorik e abstrakt, por duhet të jetë sa më konkret dhe i lidhur me përvojën jetësore, përmes shembujve dhe veprime. Arsimi duhet t'i mundësojë fëmijës të zgjidhë problemet e tij të përditshme dhe të udhëheqë një jetë më të mirë.
-Edukimi nuk është një formë kujtese (të mësuarit përmendësh), por një formë kontrolli kritik dhe të mësuarit nga praktika e jetës. Aftësia e të menduarit kritik, krijues formojnë tipare që janë të dobishme për jetën.
-Nëpërmjet edukimit duhet të zhvillohen edhe aftësitë për jetën praktike që njeriu të jetë i aftë si qytetar të zgjidh problemet konkrete dhe praktike që i shtron jeta dhe shoqëria. Mësuesi/ja shihet si orientues, udhërrëfyes, udhëheqës i një grupi, beson dhe promovon vlerat demokratike duke e vendosur nxënësin në qendër të orës së mësimit, për të nxjerr në pah personalitetin e nxënësit/es, duke e aftësuar për jetën.
- Edukimi sipas filozofit ndikon në kultivimin e vlerave në shoqëri duke sjellë përmirësimin e shoqërisë e cila orientohet sipas parimeve të mirëpërcaktuara. Reformat pedagogjike janë ndikojnë në përmirësimin e shoqërisë dhe individit si qytetar i angazhuar. Përmes mundësisë për të zhvilluar kreativitetin nxitet potenciali i secilit për të ndryshuar shoqërinë duke sjellë prosperitet.

- 3 pikë** nëse formulon dy argumente për nevojën e një edukimi praktik e jo autoritar dhe analizon ndikimin e edukimit në ndryshimin e shoqërisë;
- 2 pikë** nëse formulon dy argumente për nevojën e një edukimi praktik e jo autoritar; nëse formulon një argument për nevojën e një edukimi praktik e jo autoritar dhe analizon ndikimin e edukimit në ndryshimin e shoqërisë;
- 1 pikë** nëse formulon dy argumente për nevojën e një edukimi praktik e jo autoritar; analizon ndikimin e edukimit në ndryshimin e shoqërisë;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
-